

URDHËR
Nr. 473, datë 4.9.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCE
(Ndryshuar me Urdhër nr. 473/1, datë 1.10.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm:

a) të nënshkruajë autorizimet për përfaqësimin ligjor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në emër të personit që do të përfaqësojë ministrinë në të gjitha shkallët e gjyqimit, duke përfshirë kërkesëpadi, kërkesë, shtim, pakësim, saktësim apo heqje dorë nga objekti i kërkesëpadisë, kundërpadi, ankim dhe rekurs kundër vendimeve të ndërmjetme dhe përfundimtare, kërkesë për pezullim, kërkesë për përjashtim gjyqtari, si dhe çdo kërkesë tjetër që ka lidhje apo del nga rrethanat e gjyqimit të kësaj çështjeje, si edhe t’i nënshkruajë ato. Përfaqësuesi i autorizuar nga z. Lavdrim Sahitaj, i përcaktuar sipas kësaj pike ka të drejtë të kryejë çdo veprim procedural përpara gjykatës, konform parashikimeve të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, përveç rasteve kur kjo e drejtë kufizohet në aktin e autorizimit;

b) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor, për të gjitha procedurat e prokurimeve publike me fonde buxhetore dhe të huaja për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) delegimin e kompetencave të titullarit të autoritetit kontraktor për procedurat e koncesioneve dhe partneritetin publik privat me fonde buxhetore për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

d) autorizimet për dërgim me shërbim të punonjësve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale jashtë qendrës së punës, brenda vendit të punës, në largësi mbi 100 km dhe jashtë vendit;

e) të nënshkruajë ankimet administrative drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

f) të nënshkruajë komunikimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me institucionet e administratës publike dhe palët e treta, me përjashtim të atyre komunikimeve dhe akteve që ligji ia atribuon ministrit;

g) të ndjekë procedurat e lidhjes së marrëveshjeve të posaçme (MEA), për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

h) të nënshkruajë aktet që rregullojnë marrëdhëniet e punës për punonjësit administrativë të ministrisë;

i) të kryejë çdo veprimtari tjetër të ngarkuar me urdhër nga ministri.

j) të nënshkruajë urdhrin për dërgimin me shërbim jashtë vendit, të punonjësve të institucioneve të varësisë.

2. Këto kompetenca të ushtrohen nga z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm, duke filluar nga data 4.9.2024.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

4. Ngarkohet z. Lavdrim Sahitaj, Sekretar i Përgjithshëm dhe të gjithë nëpunësit e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 670, datë 7.11.2023, “Për delegim kompetence”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Albana Koçiu